

SHPALLJE

PËR PUNË PRAKTIKE PËR STUDENTË

Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK), është duke zbatuar projektin **“Mbështetja në punësimin e të rinjve dhe grave në zonat rurale përmes zhvillimit të bujqësisë”** projekt dyvjeçar (2020-2022), i përkrahur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Projekti përfshin komunat: **Mitrovicë e Jugut dhe Shtime**.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit është planifikuar edhe përkrahja e studentëve me punë praktike si mundësi për punësim apo vetëpunësim. Përmes këtij aktiviteti do të organizohen pesë (5) ditë trajnime profesionale të aftësive të buta dhe studentët do të sistemohen në punë praktike me pagesë në kompani, organizata apo institucione përkatëse të cilat ata do t'i kenë përcaktuar paraprakisht.

Ftohen studentët e drejtimit të bujqësisë dhe të teknologjisë ushqimore të aplikojnë për angazhim në program të praktikës që përshtatet me profesionin e tyre. Gjatë zbatimit dyvjeçar të projektit do të përkrahen gjithsej njëzet (20) studentë me punë praktike, apo dhjetë (10) studentë në vitin 2021 dhe dhjetë (10) studentë në vitin 2022. Ky grup do të angazhohet në punë praktike në kompani, institucione dhe organizata të ndryshme për një periudhë prej tre (3) muajve me kompenzim në baza mujore për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit, ushqimit dhe komunikimit.

Kandidatët e përzgjedhur duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara sipas projektit.

KRITERET QË DUHET PLOTËSUAR JANË:

- Studentë nga këto komuna: Mitrovicë e Jugut dhe Shtime;
- Studentë të cilët kanë diplomuar apo që janë në përfundim të studimeve në drejtimin bujqësi (përfshirë teknologjinë ushqimore);
- Studentë të papunë dhe që nuk kanë kryer punë praktike më parë;
- Studentë që shprehin përkushtim për pjesëmarrje në trajnime dhe në punë praktike në kompani, institucione dhe organizata;
- Studentë të gjinisë femërore dhe që janë pjesë e grupeve të pafavorizuara kanë prioritet;
- Studentë që janë të regjistruar si të papunë në Zyrat e Punësimit në komunat përkatëse kanë prioritet.
- Studentët që përzgjedhin kompani më potencial të lartë punësimi kanë prioritet.

Aplikacioni mund të merret dhe dorëzohet në:

- zyrat e IADK-së, me adresë Fshati Sfaracak i Ulët, Nr.11, Vushtrri, Kosovë;
- nëpërmjet adresës elektronike: argjend.gjinovci@iadc.org; elion.gerguri@iadc.org

Afati për aplikim është **15 janar 2021**. Për informata shtesë mund të kontaktoni në +383 (0) 49 973 204 dhe +383 (0) 44 240 106

Sinqerisht,
Zenel Bunjaku
Drejtore Ekzekutiv



Zbatuar nga:



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA